



Kumtues në Konferencën Shkencore të organizuar në Prishtinë për LShP

PJESËMARRJE E STUDIUESVE TË INSTITUTIT TË HISTORISË-TIRANË NË VEPRIMTARI TË NDRYSHME

Gjatë vitit 2007 studiuesit e Institutit të Historisë-Tiranë përveç pjesëmarrjes në veprimtari të organizuara nga Instituti i Historisë në kuadër të Akademisë së Shkencave (2007) ose Qendrës së Studimeve Albanologjike (2008) ose nga Instituti në bashkëpunim me institucione analoge, morën pjesë dhe kontribuan dhe në disa veprimtari shkencore të organizuara brenda e jashtë vendit nga institucione publike ose private të shkencës dhe arsimit, nga shoqata historianësh, bashki e komuna etj.

Në këtë kuadër më 11 tetor të vitit 2007 Marenglen Verli e Fatmira Musaj morën pjesë në simpoziumin shkencor organizuar në Kosovë nga Instituti i Historisë- Prishtinë me rastin e përvjetorit të vdekjes së atdhetarit Idris Seferi. Këta studiues gjithashtu paraqitën kumtesa në simpoziumin shkencor të organizuar në Kukës në nëntor

2003 kushtuar qëndresës lumjane kundër pushtuesit serb në dimrin e viteve 1912-1913. M. Verli paraqiti kumtesën “Roli i Islam Spahisë në qëndresën e Lumës” dhe F. Musai kumtesën “I.Boletini dhe krerët e Lumës në luftë për liri e pavarësi”.

Më 7 dhjetor 2007 Marenglen Verli, Hamit Kaba, Sonila Boçi, Muharrem Dezhgiu, Dritan Egro, Ledia Dushku morën pjesë në veprimtarinë e organizuar në Prishtinë për promovimin e librave të botuara nga Instituti i Historisë gjatë viteve 2006-2007. Në këtë kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari të organizuara jashtë vendit Ana Lalaj gjatë vitit 2007, paraqiti në Poloni kumtesën “Informbyro 1948: Faktori kyç në thyerjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave”. Në nëntor të po këtij viti ajo gjithashtu mori pjesë në një konferencë në Bullgari me kumtesën “Qëndrimi i diplomacisë amerikane ndaj thyerjes shqiptaro-sovjetike në vitet 1960-1962”.

Në qershor 2007 Kristaq Prifti mori pjesë në sesionin shkencor “Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Abdyl Frashëri” të organizuar në Tiranë nga “Shoqata kulturore-atdhetare, Përmeti”. Kumtesa e mbajtur titullohej: “Koncepti i Lidhjes së Prizrenit dhe i Abdyl Frashërit për shtetin kombëtar shqiptar”.

Në qershor 2007 Gazmend Shpuza u paraqit në Tryezën shkencore: “Mesazhet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” të organizuar në Prizren me kumtesën “Përmasat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”. Ky studiues gjithashtu mori pjesë në Ankara në Kongresin 6 Ndërkombëtare të Studimeve për Ataturkun me kumtesën “Jehona e Abrogimit të Kalifatit në Shqipëri”. Në dhjetor 2007 G. Shpuza kumtoi edhe në Konferencën Shkencore “Rumi në Ballkan” me temën “Rreth vlerësimit të ndikimit të autorëve klasikë persë në letërsinë shqipe të shekujve XVIII-XIX”.

Në maj 2007 Beqir Meta mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të organizuar në Stamboll nga Universiteti i Stambollit dhe Instituti Ballkanik i Stambollit me kumtesën “Politika shqiptare dhe greke ndaj minoriteteve respektive”. Muharrem Dezhgiu mori pjesë në Konferencën Shkencore për Studimet Albanologjike të organizuara në Ohër më 21-23 shtator 2007 me kumtesën “Veçori të pozitës së shqiptarëve në rrjedhën e Luftës së Dytë Botërore”.

Muharrem Dezhgiu dhe Beqir Meta morën pjesë me kumtesat “Litajt gjatë Luftës së Dytë Botërore” dhe “Qëndresa e Litajve kundër regjimit komunist” në një Sesion Shkencor të organizuar në Tiranë në

korrik 2007, kushtuar veprimtarisë së familjes Litaj në historinë tonë kombëtare.

Gjatë vitit 2007 studiuesit e Institutit të Historisë kanë kumtuar edhe në disa veprimtari shkencore të organizuara nga vetë Instituti, në kuadër të Akademisë së Shkencave ose në bashkëpunim me institucione analoge. Informimi për këto veprimtari jepet i plotë në faqet e këtij numri të revistës.

Marenglen VERLI